OPERATION VALUABLE – OPERACIONI I DËSHTUAR QË MORI JETËN E 300 DJEMVE SHQIPTARË

MISS BOTA 2003, BUKUROSHJA IRLANDEZE ROSANNA DAVISON “ZBULON” MËNYRËN SE SI U

VRANË 300 DJEM SHQIPTARË NË “OPERACIONIN E (PA)VLEFSHËM”!?

Ka ngjarje që, edhe pse nuk përmenden shpesh, përmenden rrallë ose nuk përmenden fare, prapëseprapë nuk harrohen kurrë.
Një ndër to është aksioni i ndërmarrë nga shërbimet angloamerikane, MI6 dhe CIA, për përmbysjen e diktaturës komuniste në Shqipëri gjatë viteve 1949–1955, i koduar me emrin Operation VALUABLE.
Lidhur me këtë dështim të Perëndimit — i cili, i trembur nga bolshevizmi që po përhapej me shpejtësi në Evropë, e përdori Shqipërinë si një eksperiment për të frenuar një fenomen të rrezikshëm për njerëzimin — sot ka shumë interpretime.
Përgatitja, zbarkimi dhe më pas ekzekutimi i të rinjve shqiptarë, bij të patriotëve nacionalistë, në operacione që mbajnë emra të ndryshëm sipas burimeve perëndimore ose atyre komuniste, përbën një nga tragjeditë më të mëdha të kombit tonë.
Në mesin e shkaqeve të këtij dështimi përmenden:

• tradhtia e agjentit britanik Kim Philby, i cili ia kaloi informacionet jetike shërbimit sekret sovjetik dhe, drejtpërdrejt, regjimit të Tiranës;
• mungesa e gatishmërisë së popullit shqiptar për t'u ngritur kundër diktaturës së Enver Hoxhës;

• organizimi i Sigurimit të Shtetit sipas modeleve staliniste të kohës.

Propaganda komuniste e paraqiti këtë si një "fitore të saj", por në të vërtetë ishte thjesht dobësia dhe tradhtia e një individi, Kim Philby, që nuk i solli asgjë të mirë as shërbimeve që e paguanin dhe as Shqipërisë. Ka madje njëfarë paraleleje mes tij dhe funksionarit të FBI-së në ditët tona, Charles McGonigal, i cili, po ashtu, nuk i solli asgjë të mirë as Amerikës dhe aq më pak demokracisë shqiptare.
Unë nuk kam ndërmend të analizoj në mënyrë të detajuar ngjarjet e atyre viteve, sado dhimbje të ndjej për jetët e humbura të rinisë shqiptare. Atë e kanë bërë tashmë, sipas mënyrës së tyre emra të tillë si
• David Smiley, në librin Albanian Assignment;
• Lordi Nicholas Bethell, në librin Tradhëtia e Madhe;

• Koloneli Okley Hill, në librin Një Anglez në Shqipëri;
• si dhe Sigurimi i Shtetit, në filmin propagandistik Detyrë e Posaçme.
Ky i fundit angazhoi disa artistë renegatë, të cilët, duke luajtur me gjakun e vëllezërve të tyre të rënë, përfituan favore nga pushteti komunist — favore që i gëzojnë, fatkeqësisht, edhe sot nipat dhe mbesat e tyre.
Por ndryshe nga të gjithë këta, që kanë shkruar, interpretuar ose manipuluar këtë histori sipas mënyrës së tyre, sot do të sjell para jush një dëshmi të drejtpërdrejtë: rrëfimin e një dëshmitareje të gjallë, një grua që ka shërbyer në bazën ushtarake Fort Bingemma në Maltë, aty ku u përgatitën djemtë shqiptarë për zbarkimin në atdhe.
Këtë histori e ka konstatuar për herë të parë gazetari shqiptaro-irlandez Ndrek Gjini, pasi ndoqi dokumentarin A E DINI SE KUSH JENI JU?, prodhim i televizionit irlandez.
Dokumentari sjell një zbulim të pazakontë: Personazhi kryesor është Miss Bota 2003, një irlandeze që, duke gjurmuar prejardhjen e familjes së saj deri në vitin 1080, has papritur në një fakt tronditës — lidhjen e

gjyshes dhe gjyshit të saj me operacionet angloamerikane në Shqipëri gjatë viteve 1949–1955. Kureshtjen time për ta sjell këtë film tek ju, të dashur shikues, e shtoi edhe njohja personale me historianin Roderick Bailey, një nga studiuesit më të thelluar të kësaj teme dhe pjesëmarrës në dokumentar.
Në vitin 2013 pata nderin ta mirëpres atë në Ambasadën e Shqipërisë në Londër dhe, së bashku me Anglo Albanian Association, të përurojmë librin e tij The Wildest Province – SOE in the Land of the Eagle. Për këtë temë kam shkruar edhe më parë, por sot nuk është rasti të zgjatem.
Sot është momenti të dëgjojmë zërin e dëshmitarëve. Të shohim se çfarë tregon historia kur e rrëfejnë ata që e kanë parë me sytë e tyre.
Le ta ndjekim dokumentarin dhe të kuptojmë se si 300 djem shqiptarë u hodhën drejt vdekjes, viktima të një lufte të fshehtë, të humbur pa lavdi... viktima të një populli nën diktaturë dhe të tradhtuar nga renegatë që, fatkeqësisht, i shohim edhe sot duke lëvizur nëpër rrugat madje edhe zyrat e shtetit tonë.
Shikim të mbarë.

OPERATION VALUABLE – OPERACIONI I DËSHTUAR QË MORI JETËN E 300 DJEMVE SHQIPTARË

RRËFIMTARI:– Rosanna Davison ishte vajza e parë irlandeze që u kurorëzua Miss Bota në vitin 2003.
Që kur e fitoi këtë titulli, 25-vjeçarja ka ndërtuar një karrierë të suksesshme modelimi në Irlandë dhe jashtë saj.
Si vajza e një këngëtari të famshëm, Rosanna është mësuar me dritat e skenës.
Por tani ka vendosur t'i drejtojë ato tek paraardhësit e saj, për të zbuluar nëse fama dhe popullariteti janë një tipar familjar.
ROSANNA DAVISON – Aktualisht, unë di shumë pak përveç gjyshërve të mi.
Shpresoj që këto ditë të zbuloj diçka që të më surprizojë.
RODERICK BEILEY – Më në fund, këtu në fund të kësaj faqeje të kësaj letre keni diçka që është shkruar nga gjyshja juaj.
ROSANNA DAVISON – Dhe shkrimi qenka kaq i bukur.
RODERICK BEILEY – Këtu thuhet se ai nuk është më i interesuar të marrë një *Short Service Commission*,

pasi ka pranuar një detyrë tjetër dhe e ka lënë vendin. Nuk jam... nuk jam i sigurt... tingëllon mjaft intriguese, sepse këtu mbaron dosja.

ROSANNA DAVISON – Po!

RODERICK BEILEY – Dhe a do të ishte interesante të zbulohej se çfarë ishte ajo detyrë?

ROSANNA DAVISON – Tungjatjeta, gjyshe, si je?

GJYSHJA – Ohhh, po! Si je ti?

ROSANNA DAVISON – Ne sapo lexuam një letër të shkruar prej teje, dhe po pyesnim se përse ti nuk mund ta merrje atë detyrë, dhe se ku shkoi ai në vend që të shkonte në Malajë.

GJYSHJA – Eh! Atij i ofruan një post tjetër, në Maltë.

ROSANNA DAVISON – Dhe çfarë lloj posti do të ishte ai?

GJYSHJA – Eh, ishte punë zyrtare, ushtarake, por në fakt ishte punë spiunazhi. Ai i trajnonte agjentë që të zbarkonin në Shqipëri.

ROSANNA DAVISON – Uau, pra ishte një gjë shumë sekrete...?

GJYSHJA – Po, ai i mësonte se si të hidhnin objekte në erë, dhe përgjithësisht si të shkaktonin sa më shumë trazira.

ROSANNA DAVISON – Po ti, çfarë bëje në atë kohë?
GJYSHJA – Unë shkoja me të në atë bazë ku bëhej stërvitja. Unë e bëja gjithë shifrimin dhe deshifrimin kur agjentët hidheshin natën në Shqipëri.
Më duhej të rrija zgjuar gjithë natën, gati për të marrë mesazhet dhe për t'i dërguar në Londër.
ROSANNA DAVISON – Gjyshe, ky është një aspekt i jetës tënde që unë nuk e kam ditur kurrë. Ti nuk ma ke treguar kurrë këtë. Si ka mundësi që shtiheshe sikur ishe ndonjë bareshë delesh apo mbarështruese kuajsh!?
Nuk e kisha ditur këtë. Jam shumë, shumë e habitur.
GJYSHJA – Kam pasur shumë ngjarje emocionale në jetën time. Prandaj tani e shijoj kaq shumë këtë jetë të qetë.
ROSANNA DAVISON – Roderick, ju e dëgjuat bisedën?
RODERICK BEILEY – Po.
ROSANNA DAVISON – E çfarë mendon për këtë?
RODERICK BEILEY – Epo, mund të nënkuptojmë një gjë: Ai ishte një operacion tejet sekret dhe shumë i diskutueshëm.
Ishte një nga përpjekjet e para të ndërmarra gjatë Luftës së Ftohtë për të destabilizuar një qeveri

komuniste kudo në botë. Ajo u ndërmor bashkërisht nga MI6 dhe CIA. Operacioni konsistonte në hedhjen me parashutë dhe infiltrimin e emigrantëve shqiptarë në Shqipëri, me qëllim që ta rrëzonin qeverinë.
Këto lloj operacionesh mbeten sekrete për një kohë shumë, shumë të gjatë.
RRËFIMTARI: – Pas Luftës së Dytë Botërore, ndikimi sovjetik filloi të përhapej në të gjithë Europën Lindore, duke shkaktuar shqetësim të madh në Perëndim. Shqipëria u bë një nga shtetet e reja komuniste më të egra nën diktaturën e Enver Hoxhës.
Por Rosanna sapo ka mësuar se gjyshërit e saj u dërguan në Maltë si pjesë e **Operacionit VALUABLE**, një plan i përbashkët britanik dhe amerikan për të dobësuar dhe përmbysur regjimin komunist shqiptar. Rosanna ka fluturuar drejt Maltës, e bindur se ishte pikërisht në prag të një zbulimi të madh lidhur me emërimin në atë post sekret të gjyshit të saj në atë ishull.
Historiani lokal **Mario Felucia** është përpjekur të zbulojë më shumë detaje për të.
ROSANNA DAVISON – A keni ndonjë kujtim tjetër rreth asaj që ata po bënin dhe pse ishin këtu?

MARIO FELUCIA – Sipas informacionit që kemi, ata janë trajnuar në Fort Bingemma.
Megjithatë, mund të kenë qenë trajnuar edhe në Fort Manuel.
Dhe kjo sepse këto janë të njëjtat baza të vjetra që u përdorën nga SOE gjatë Luftës së Dytë Botërore.
ROSANNA DAVISON – A është dikush tjetër që e ka këtë informacion?
MARIO FELUCIA – Jo, fatkeqësisht nuk kemi gjetur askënd.
Madje kemi vendosur edhe një njoftim në gazeta, dhe askush nuk është përgjigjur.
Mendoj se ishte tepër sekret.
ROSANNA DAVISON – Po.
MARIO FELUCIA – Dhe kjo të jep njëfarë ideje të përgjithshme rreth asaj se çfarë përmbajnë këto operacione.
Ajo që dimë me siguri është se gjithë aktiviteti, pra, aktiviteti i trajnimit, është zhvilluar rreth atyre zonave, në Fort Bingemma dhe ndoshta edhe në Fort Manuel.
Çfarë përbën një veçanti, është se ai ishte një vend shumë i izoluar dhe ndodhet në veriperëndim të

ishullit, që është një nga pikat më të largëta të tij.
Dhe pastaj ndiqej një shteg!
ROSANNA DAVISON – Tani jam në një pikë ku kam mbledhur një sasi të caktuar informacioni dhe një vendndodhje se ku gjyshërit e mi ishin vendosur në fillim të viteve 1950.
Dhe... por ndjej sikur jemi diku në prag të diçkaje.
Kështu që është jashtëzakonisht emocionuese dhe e befasuese!
Dhe për mua, të mendoj që kemi ardhur kaq larg dhe ende ka gjithë këto informacione për t'u zbuluar...!
Mendoj se kjo mund të jetë juaja.
Përshëndetje, a është... a është ky Fort Bingemma?
BANOR LOKAL – Po, ky është Fort Bingemma!
ROSANNA DAVISON – Atëherë jam në vendin e duhur.
Unë quhem Rosanna.
BANOR LOKAL – Unë quhem Salzano.
ROSANNA DAVISON – Kënaqësi që u njohëm!
Po t'ju pyesja, si e kujtoni këtë fortesë, le të themi, rreth kohës së Luftës së Ftohtë, që nga fundi i viteve 1940?
BANOR LOKAL – Ah, unë isha shumë i ri në atë kohë për të kuptuar se çfarë po ndodhte këtu.

ROSANNA DAVISON – Është kaq i bukur... Dua të them, do të më pëlqente të hyja brenda dhe të shikoja këtë vend!?
BANOR LOKAL – Po, hajdeni dhe hidhni një rreth e qark!
ROSANNA DAVISON – Faleminderit.
RRËFIMTARI: Gati 60 vjet më parë, këtu është vendi ku gjyshërit e Rosannës ndihmuan në stërvitjen e të rinjve shqiptarë për të përmbysur komunizmin.
ROSANNA DAVISON – Është e mahnitshme të mendosh që ky është vendi ku gjyshërit e mi me shumë gjasë do të kenë jetuar...
RRËFIMTARI: Operacioni VALUABLE ishte tepër sekret.
Edhe sot, asnjë dokument zyrtar nuk u vihet në dispozicion historianëve.
Por koloneli David Smiley, i cili mbikëqyri projektin në Maltë, ka shkruar shkurtimisht për operacionin në librin e tij *The Albanian Assignment*:
“Fillimisht, duhej gjetur akomodimi për shqiptarët dhe më pas duhej shpikur maskimi i tyre.
Fort Bingemma, i ndërtuar gjatë Luftërave Napoleonike, i plotësonte këto kushte.

Aty mund të kaloje vetëm përmes një shtegu të vështirë.

ROSANNA DAVISON – Kjo është shumë interesante.

Ai shkruan:

“Meqenëse të gjitha komunikimet e mia me Londrën duhej të ishin të koduara, më duhej një operator i kodeve.

Kështu që gruaja ime, Moy, në Maltë, ishte përgjegjëse për gjithë punën e kodimit dhe dekodimit të forcës.”

Dhe kjo tingëllon pikërisht njësoj si ajo që përshkroi gjyshja ime për atë që bënte atje.”

ROSANNA DAVISON – Tani kjo është interesante.

Mendoj se kam zbuluar një lloj anomalie historike.

ROSANNA DAVISON – Ai shkruan: *“Pasi të gjitha grupet u hodhën matanë në brigjet tjera, stacioni në Maltë u mbyll dhe unë u transferova në Greqi.”*

Kjo është shumë e çuditshme, sepse gjyshi im në fakt e kishte pranuar këtë post, dhe ky vend nuk u mbyll fare.

Ai vazhdoi të funksiononte.

Kështu që, nuk jam e sigurt, por ky mund të përbëjë thjesht sekretin absolut të kësaj force.

Gjyshja ime ka qenë një “kalë vërtetë i zi” një surprizë e madhe.
Unë gjithmonë e kam ditur se ajo ishte një grua jashtëzakonisht e zgjuar.
Por nuk kisha asnjë ide se ajo ishte e përfshirë kaq thellë në gjë të tillë.
E di, kam marrë një vendim tani që këtë verë të kaloj shumë kohë me të, thjesht... thjesht duke folur bashkë.
Nuk dua të bëj të njëjtin gabim me të, siç bëra me gjyshin.
RRËFIMTARI: Përse Rosanna po e gjurmonte të shkuarën sekrete të gjyshërve të saj në Maltë?
Roderick Bailey ka zbuluar më shumë rreth Operacionit VALUABLE.
Duket se informacioni i dhënë nga gjyshja e Rosannës e ka rishkruar historinë.
Operacioni VALUABLE nuk përfundoi kur kolonel David Smiley u largua nga Malta.
Trajnimi sekret vazhdoi nën drejtimin e Charles Davison.
Ai mbërriti në Maltë pikërisht në kohën kur në përgjithësi mendohej se operacioni kishte marrë fund.

RODERICK BAILEY – Roli i gjyshit tuaj, siç e dini, ishte të trajnonte këta të rinj shqiptarë, dhe ai ishte perfekt për ta bërë atë punë.
Ai do t'u mësonte gjithashtu se si të përdornin radiot, si të vrisnin, si të vendosnin eksplozivë, e kështu me radhë.
Këto janë të gjitha gjërat që, sigurisht, ai i kishte mësuar gjatë luftës.
Kështu që ai kishte shumë përvojë në këso lloj aktivitetesh.
Ai ishte shumë i aftë!
Roderick Beiley – Po, absolutisht.
Dhe kur trajnimi përfundoi, ata i merrnin agjentët nga Fort Bingemma dhe i dërgonin në Shqipëri në dy mënyra.
Njëra ishte tokësore, përmes Greqisë, ndërsa mënyra tjetër ishte me anije zbarkimi në det.
Ata merreshin me anije nga Malta, nga një prej këtyre porteve këtu, dhe çoheshin në bregdetin shqiptar. Aty zbarkonin në mes të natës.
Tani, ka edhe një gjë tjetër që duhet ta dini për gjithë këtë operacion:

Fakti që ai ishte një katastrofë e plotë, pothuajse nga fillimi deri në fund.
ROSANNA DAVISON – Vërtet?
RODERICK BEILEY – Po. Dhe shqiptarët vetë, të rinjtë shqiptarë që u trajnuan në Fort Bingemma, në atë vendin që e vizituat, shumë prej tyre u kapën, u torturuan dhe u ekzekutuan.
Disa arritën të shpëtonin.
Disa u rikthyen këtu, por...
Ata treguan histori të tmerrshme se si ishte gjendja në atë vend.
Që nuk kishte... kishte shumë pak mundësi për çfarëdo lloj suksesi.
Sigurimi komunist ishte jashtëzakonisht i egër.
Në fakt nuk ishte aspak faji i trajnerëve britanikë.
I gjithë operacioni ishte... ishte i mangët në vetvete.
ROSANNA DAVISON – A i dini pikat e vërteta të mangësive?
RODERICK BEILEY – Po. Ata e mbivlerësuan tepër aftësinë e popullatës shqiptare për t'u ngritur kundër qeverisë komuniste.
Po ashtu, përgjithësisht besohet se një agjent i dyfishtë britanik ishte aktiv. Ai quhej **Kim Philby**, i cili

“shërbente” në Uashington në atë kohë.
Mendohet se ai i kaloi sekretet e këtij misioni tek komunistët.
RRËFIMTARI: Pavarësisht përpjekjeve më të mira të babait të Rosannës, gjithë puna e tij u hodh poshtë. Sekreti absolut i Operacionit VALUABLE u minua nga ai spiun i brendshëm, gjë që do të thoshte se regjimi komunist në Shqipëri i dinte se kur dhe ku do të zbrisnin të trajnuarit.
Dështimi i Operacionit VALUABLE çoi në vdekjen e të paktën 300 djemve shqiptarë.
Edhe sot, është një nga operacionet më pak të njohura të kohës së Luftës së Ftohtë.
ROSANNA DAVISON – Kjo nuk e ndryshon domosdoshmërisht qëndrimin tim ndaj gjyshërve të mi dhe asaj që ata bënë.
Jam e zhgënjyer për ta, e di.
Në një farë mënyre po përpiqem të ruaj empatinë për ta, edhe pse në një mënyrë apo tjetër u përfshinë në fatin tragjik të kaq shumë njerëzve dhe u bënë deri diku përgjegjës për humbjen e kaq shumë jetëve shqiptare.
RODERICK BEILEY – Vështirë të flitet për këtë, sepse në fakt rezultoi një katastrofë.

ROSANNA DAVISON – Informacioni që kam dhe që e kam mbledhur në kokën time...
Pra, gjyshi im më thoshte se, çdo gjë që ai e dinte, e dija edhe unë.
Me besimin e tij të plotë dhe gjithë aftësinë e tij, çdo mision do të ishte i garantuar që do të kishte sukses.
E di, deri tani kam besuar në gjithçka që ai mund të bënte; çdo gjë që merrte përsipër, mund ta realizonte dhe të ishte i suksesshëm në të.
Kështu që është paksa si një tronditje për mua, në të vërtetë.
Besoj se po e ndiej edhe unë humbjen dhe zhgënjimin e tyre.
RRËFIMTARI: Kërkimi i pemës së saj familjare e ka çuar Rosannën larg e më larg,
por më në fund e rikthen në Irlandë, aty ku kërkimi i saj filloi, në shtëpinë e gjyshes së saj, në Wexford.
ROSANNA DAVISON – Po, a je ende e detyruar ta mbash këtë informacion sekret?
Apo thjesht je mësuar të mos flasësh për të?
Apo, a mund të kishe folur hapur me dikë tjetër?

GJYSHJA – Sigurisht që nuk mund të flisje për shumë vite, sepse e kisha nënshkruar Aktin e Sekreteve Zyrtare. Dhe ai të detyron të qëndrosh e heshtur.
ROSANNA DAVISON – Si e maskoje atë që po bëje atje?
GJYSHJA – Thjesht jetoja në një mënyrë shumë të zakonshme.
Nuk kisha pse të fshihesha. Fëmijët shkonin në një shkollë ushtarake, në një shkollë të vogël ushtarake. Ne prisnim lajme që vinin nga...
ROSANNA DAVISON – A ishte më shumë punë nate?
GJYSHJA – Trajnimi zhvillohej gjatë ditës, ndërsa zbarkimet bëheshin natën. Po, trajnimi vazhdonte gjatë ditës.
ROSANNA DAVISON – Mirë, kur u larguat nga Malta, a ishe e interesuar të dije se si përfundoi operacioni?
GJYSHJA – Në të vërtetë neve nuk na tregonin. Ne dinim vetëm ato që merrnim me mend dhe që mund t'i kuptonim nga gjërat që ndodhnin përreth.
ROSANNA DAVISON – Sepse ne mësuam atje, që në fakt ishte një lloj katastrofe, se shumë nga shqiptarët vdiqën.

ROSANNA DAVISON – A u mërzite që operacioni në fakt nuk pati sukses?
GJYSHJA – Po, u mërzitëm, por ne nuk kishim çfarë të bënim, po.
Ishte e trishtueshme, sepse ishin djem të rinj shumë të mirë.
ROSANNA DAVISON – Dua të them, unë... unë nuk e kam ditur kurrë këtë.
Besoj se nuk të kam pyetur asnjëherë, për jetën tënde...!
GJYSHJA – Po, kam frikë se ata... nuk... ata vdiqën. Është shumë e trishtë ta dëgjosh këtë.
ROSANNA DAVISON – Si u përballe ti me këtë fakt?
GJYSHJA – U zhgënjeva që gjithçka mori fund ashtu. Por... më vjen keq... vërtet më vjen shumë keq që përfundoi ashtu siç përfundoi. Ti nuk më ke pyetur kurrë, e di.
Mendoj se gjithmonë merret me mend se njerëzit kanë lloj-lloj kujtimesh, nga më të habitshmet pothuajse gjithkush në këtë botë.
ROSANNA DAVISON – Mendoj se një nga burimet më të rëndësishme të këtij udhëtimi, të të gjithë këtij udhëtimi, të kuptimit të gjithë kësaj rruge zbulimi, do

të mbetet pjesë e jetës sime përgjithmonë.
Ka qenë ajo, gjyshja ime, personi që gjithmonë e kam admiruar, dhe e di që gjithmonë kam pasur mendimin më të mirë për të.
Por ajo ka qenë këtu me gjithë këtë informacion... dhe mua... nuk më kishte shkuar kurrë mendja që ta pyesja.

FUND

Narrator – Rosanna Davison was the first Irish woman to be crowned Miss World in 2003.
Since winning the title, the 25-year-old has carved out a successful modeling career in Ireland and abroad.
As the daughter of a famous singer, Rosanna is used to the spotlight.
But has now decided to cast it on her ancestors to see if fame and notoriety are a family trait.

Rosanna Davison – At the moment, I do know very little beyond my grandparents.
I will hopefully be surprised by what I learn in the days to come.

Roderick Beiley – Finally, you have this letter at the end here, which is written by your grandmother.

Rosanna Davison – And now the writing is so well.

Roderick Beiley – And it says that he's no longer interested in obtaining a Short Service Commission, as he's accepted another post and has left the country. I'm not—I'm not… that sounds quite intriguing, because that's the end of the file.

Rosanna Davison – Yeah!

Roderick Beiley – And it might be interesting to find out what that post was?

Rosanna Davison – Hi Granny, how are you?

Granny – Ohhh, yeah! How are you?

Rosanna Davison – We just read a letter written by you, and we were just wondering why — why you couldn't take the post, and where he actually went instead of going to Malaya.

Granny – Well — he was offered a posting in Malta.

Rosanna Davison – And what sort of work would that have been involved?

Granny – Well — it was official army work, but in fact there was some intelligence work.
He was training agents to be put into Albania.

Rosanna Davison – Wow, so it was again highly secret…

Granny – And he was teaching them how to blow things up, and generally cause lots of disruption.

Rosanna Davison - And what were you doing then?

Granny – I used to go with him to this base where we did the training, and I did all the coding and decoding when the agents were being dropped at night in Albania.
I used to be up there all night, ready to take messages and send them out to London.

Rosanna Davison – Granny, that's an aspect of your life I never knew about.
You never told me this. How you just pretended you were some sheep farmer or horse breeder.
I never knew that. I'm very, very impressed.

Granny – I've had lots of excitement in my life, oh yeah, that's why I so much enjoy a peaceful life nowadays.

Rosanna Davison – So, you heard that conversation?

Roderick Beiley – Yes, it is—it's…

Rosanna Davison – What would you make of it?

Roderick Beiley – Well, it can mean only one thing. It's a highly secret and controversial operation. One of the first Cold War attempts to destabilize a communist government anywhere in the world. And it was run jointly by MI6 and the CIA. And the operation was to parachute and infiltrate Albanian exiles into Albania in a way to hopefully overthrow the government.
These sorts of operations are secret for a very, very long time.

Narrator – After World War II, Soviet influence began to spread throughout Eastern Europe, causing great concern to the West. Albania became one of the most hardline new communist states under the dictatorship of Enver Hoxha. But Rosanna has just learned that her grandparents were sent to Malta as part of Operation VALUABLE, a joint British and American plan to undermine and overthrow the communist Albanian regime. Rosanna has flown to Malta, furious about her grandfather's secret posting here on the island.

Local historian Mario Felucia has been trying to unearth some more details for her.

Rosanna Davison – Do you have any more memories about what they were doing and why they were here?

Mario Felucia – Given the information we have, is that they were trained at Fort Bingemma.
However, they could also have been trained at Fort Manuel.
And that's because these are the same old bases that were used by the SOE during the Second World War.

Rosanna Davison – Is there anybody else who has this information?

Mario Felucia – No, unfortunately we haven't found anyone.
In fact, we've also run an ad in the papers, and no one would come forward.
I think it was so top secret.

Rosanna Davison – Yeah.

Mario Felucia – There are very few local people in particular who have been involved.
What I can provide you with is this book, which is about *The ALBANIAN ASSIGNMENT*.

Rosanna Davison – OK!

Mario Felucia – And it gives you some background about, you know, what these operations entail. What we know for sure is that all the activity — that is, the training activity — took place around those places, at Fort Bingemma and possibly also Fort Manuel. For the gentleman in particular, it is very isolated. It is in the north-northwest of the island, which is one of the farthest points on the island.
And then you take a track!

Rosanna Davison – I'm at a point now where I've got a certain amount of information and a location on where my grandparents, you know, were based during the early 1950s.
And, but I feel like we're sort of on the cusp of something.
So it's incredibly exciting and thrilling.
And for me to think that we've come this far and there's still all this information to find out…!
I think this could be yours.
Hi there, is this… is this Fort Bingemma?

A local resident – Yes, this is Fort Bingemma!

Rosanna Davison – Then I'm in the right place.
Well, my name is Rosanna.

A local resident – My name is Salzano.

Rosanna Davison – Nice to meet you!

Rosanna Davison – I was just wondering, how do you remember this fort from, say, around the time of the Cold War, from the late 1940s?

A local resident – So I was too young to dig into what was happening here?

Rosanna Davison – That's such a pretty… I mean, I'd love to come in and have a look at your place.

A local resident – Yes, come and have a look around!

Rosanna Davison – Thank you.

Narrator – Almost 60 years ago, this is where Rosanna's grandparents helped to train young Albanian men to try to overthrow communism.

Rosanna Davison – It's amazing to think that this is where my grandparents probably would have stood.

Narrator – Operation VALUABLE was highly secret. Even today, no official records are available to historians.
But Colonel David Smiley, who supervised the

project in Malta, wrote briefly about the operation in his book *The Albanian Assignment*:
“First, accommodation for the Albanians had to be found, and then their cover had to be invented. Fort Bingemma, built during the Napoleonic Wars, fitted the bill.
It could be approached only by a rough track.”

Rosanna Davison – “This is very interesting.
He goes: ‘As all my signals to and from London had to be in code, I needed a cipher clerk.
So my wife Moy, in Malta, was responsible for all the cipher work of the force.’
And that sounds exactly the same as what my grandmother described she was doing.”

Rosanna Davison – Now this is interesting.
I think I’ve discovered a sort of anomaly to the story.

Rosanna Davison – He goes: “Once all the groups have been put ashore, the station at Malta closed down, and I moved to Greece.”
Now that’s very strange, because my grandfather actually accepted this post, and this place did not shut down.
It continued.

So, I'm not sure, but that may just point to the absolute secrecy of this force.

My granny has been a major dark horse, and I always knew that she was a highly intelligent woman.
But I had no idea that she was really so deeply involved in something like this.

You know, I've made a decision now to spend a lot of time with her this summer, and just… just was talking about us.
You know, I'm not going to make the same mistake with her that I made with grandpa.

Narrator – Why Rosanna has been retracing her grandparents' secret past in Malta.
Roderick Bailey has been uncovering more about Operation VALUABLE.
It does seem that Rosanna's grandmother's information has rewritten history.
Operation VALUABLE didn't end when Colonel David Smiley left Malta.
The covert training continued under Charles Davison.
He arrived in Malta just at the time when generally it's thought that the operation came to an end.

Roderick Bailey – Your grandfather's role, as you know, was to train these young Albanians, and he was perfect for doing the job.
And he would also be teaching them how to use radios, how to kill, how to lay explosives, and so on. These are all the things that, of course, he learned during the war.
So, he was very experienced at that kind of activity. He was very skilled!

Roderick Beiley – Yeah, absolutely.
And when the training finished, they would have taken the agents away from Fort Bingemma and sent them into Albania by two ways.
One was over land through Greece, but another way was by boat.
And they would have been taken by boat from Malta, from one of these docks here, and taken across to the Albanian coast, and dumped off in the middle of the night.

Now, there's one other thing that you should know about this whole operation, and that is the fact that it was a complete disaster, pretty much from start to finish.

Rosanna Davison – Really?

Roderick Beiley – And that the Albanians themselves, the young Albanians you were training at the Fort Bingemma you visited, a great many of them were caught, and they were also tortured and executed.
Some of them did manage to get away.
Some did make it back here, yeah.

Roderick Beiley – But they told terrible stories of what it was like in the country.
That there was no… there was very little chance of any sort of success.
The communist security was very, very tight.
But it wasn't the fault of the British trainers at all.
The whole enterprise was… it was flawed.

Rosanna Davison – Do you know pinpoints of certain issues?

Roderick Beiley – Yes. They overestimated the ability of Albanian communities to rise against the communist government.
And also, it's generally thought that a British double agent was at work, exactly called Kim Philby, who was working in Washington at the time,
and it's thought that he passed secrets to the communists.

Narrator – Despite Rosanna's father's best efforts, all his work was undone.
The utter secrecy of Operation VALUABLE was undermined by a mole, which meant the communist regime in Albania was waiting for the insurgents.
The failure of Operation VALUABLE led to the death of at least 300 men.
To this day, it is one of the least-known operations of the Cold War.

Rosanna Davison – It doesn't change my attitude necessarily towards my grandparents and what they did.
I'm disappointed for them, you know.
I'm sort of trying to empathize with her… very much… in that they sort of implicated so many lives, and they were responsible to some degree for the loss of so many Albanian lives.

Roderick Beiley – It's uncomfortable to talk about, because it did turn out to be a disaster.

Rosanna Davison – The information I have, um, put together mentally in my head…
So I had—my grandfather said to me, okay, anything he puts his, you know, full confidence into, and his full ability into, will be guaranteed success.
You know, I really, up until now, believed in everything he could do—he could pull off and be

wonderful at.
So it's a bit of a jolt to the system, really.
I suppose I'm feeling their loss and their disappointment as much too.

Narrator – Tracing her family tree has taken Rosanna far and wide,
but finally it brings her back to Ireland, where her search began, at her grandmother's, in Wexford.

Rosanna Davison – Yeah, were you still used to using and keeping this information secret, that you just got to not talking about it, or could you have openly talked about it to anyone else?

Granny – Of course you couldn't speak for many years, you know, because you had to have signed the Official Secrets Act, and it kept you quiet.

Rosanna Davison – How did you disguise what you were doing there?

Granny – You just lived in a very ordinary way.
You didn't have to hide; children went to an army school, a little army school.
We used to wait for news coming from…

Rosanna Davison – Was it very much a night-time?

Granny – The training went on during the day.
The landings were night-time, but the training went on during the daytime.

Rosanna Davison – Well, when you left Malta, I mean, were you anxious to know the outcome of the operation?

Granny – I mean, you really were not told, and it was the surrounding things that might have happened.

Rosanna Davison – Because we discovered, you know, over there, that it actually was a bit of a disaster, that a lot of the Albanians died.

Granny – Yes, I'm afraid they… not died.
It is very sad to hear that.

Rosanna Davison – How did you deal with that?

Granny – I was disappointed that it was over.
But sorry… it really… very sorry that it should have ended as it did.

Rosanna Davison - Were you upset so the operation didn't actually succeed it?

Granny – Yes, we were upset that there's nothing we could do about it, yeah.
It was sad because they were nice young fellows.

Rosanna Davison – I mean, I've… I have never knew about this.
I suppose I haven't ever questioned, you know, about your life.

Granny – You never asked me, you know.
I think you always find that other people have all sorts of amazing memories, almost everybody.

Rosanna Davison – I suppose one of the most crucial resources for this whole trip — this whole trip, understanding this whole journey of discovery — has been a part of my life forever.
It’s been, you know, my grandmother, this person who I've always admired, and I know I've always thought the world of.
But she's been here with all this information… my… I never thought of asking her.